



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës* bënë:

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Intervistues për të realizuar intervistat për Anketën TIK 2020 dhe SILC 2020
Numri i referencës:	ASK-DSS-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Mbikëqyrësit e Anketës TIK dhe SILC/Njësia e standardit jetësor, ASK
Lloji I kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta–(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Deri në gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-1 (1 anketues)

Detyrat dhe përgjegjësitë e anketuesit

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me udhëzimet metodologjike dhe organizative përfshirë pyetësonin e ekonomisë familjare dhe pyetësonin individual dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën TIK dhe SILC;
- Të zhvillojë grumbullimin e të dhënave për anketën e TIK dhe SILC me metodologjinë CAPI (tabletë).
- Të bëjë identifikimin e ekonomisë familjare duke u bazuar në listat e ekonomive familjare dhe në harta si dhe të respektohet kriteri për individët për moshën 16 deri 74 vjeç për anketën TIK ndërsa për anketën SILC të respektohet kriteri për të gjithë individët e ekonomisë familjare dhe duke intervistuar të gjithë anëtarët që plotësojnë kriterin për moshën (16 vjeç e më shumë të plotësoj pyetësonin individual);
- Të respektoj udhëzimet e pyetësonit për pyetjet që nuk duhet t'i parashtrajnë disa të anketuarve dhe të respektojnë të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia familjare, obligohen të kontrollojnë pyetësonin elektronik të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Të vizitoj përsëri për të intervistuar ekonomitë familjare/ individët të cilët nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Identifikimi i adresave dhe kodeve në hartë të cilat janë të përcaktuara në qarqet regjistruese dhe ekonomitë familjare në anketën TIK dhe SILC;
- Përdorimi i koordinatave për gjetjen e adresave të ekonomive familjare të intervistuar në vitin 2019 që janë përzgjedhur për ri-intervistim dhe përdorimi i adresave dhe hartave për Qarqet Regjistruese dhe ekonomitë familjare të caktuara në valën e tretë SILC 2020;
- Të njoftojë mbikëqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkohet ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista të zhvillohet në gjuhën të cilën i përket komunitetit të cilin është përzgjedhur për intervistim.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi;
- Të përfundojnë sipas afatit Anketa e TIK dhe SILC ;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në familjet e anketuara si sekret zyrtar.
- Të ktheje pajisjet e pranuar nga ASK (tabletë), pas përfundimit të punës në teren.

Përgatitja shkollore për anketues/përvoja:

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme;
- Të kenë përvojë pune, e preferuar përvoja në anketa;
- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë informative (laptopëve / tabletave);
- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marrë pjesë së paku në një anketë.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të kenë njohuri në përdorimin e kodeve të hartave për identifikimin e objekteve të banimit;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet anketa e TIK dhe SILC;

- Të jenë të gatshëm të punojnë sipas nevojës me orar pune më të gjatë, përfshirë fundjavat.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në media dhe web faqen e ASK-së.

Numri i anketueseve sipas etnitetit dhe regjionit:

Regjioni	Anketues Shqiptar	Anketues Serb
Prishtinë		1
Total		1

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr.”Zenel Salihu” nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t’i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, diploma e fakultetit për pozitën mbikëqyrës ndërsa diploma e shkollës së mesme për pozitën anketues (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje). Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t’i nënshtrohen intervistës me gojë. Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit , në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 151 prej orës 08:00 – 16: 00.

¹ Përfshirë: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike